

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë Misioni në Kosovë



Rreth nesh

Misioni i OSBE-së punon për të përmirësuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të komuniteteve, qeverisjen e mirë dhe standardet e sigurisë publike në Kosovë. I themeluar në vitin 1999, ky është Misioni më i madh i OSBE-së.

Është e vetmja organizatë civile ndërkombëtare e pranishme në mbarë Kosovën që monitoron nga afër zhvillimet politike, institucionale dhe të sigurisë dhe ofron rekomandime për përmirësime aty ku është e nevojshme.

Një nga objektivat kryesore të Misionit është zhvillimi i mëturshëm i shoqërisë demokratike dhe shumë-etnike në Kosovë, ku respektohen të drejtat e secilit. Në këtë drejtim, Misioni mbështet institucionet përmes trajnimeve, avokimit, dhe ofrimit të ekspertizës. Misioni ka mbështetur themelimin e një numri institucionesh kyçe, duke përfshirë Kuvendin e Kosovës, Institucionin e Avokatit të Popullit, Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Zyrën e Komisionerit për Gjuhët dhe organet komunale për mbrojtjen e komuniteteve.

Prania

Misioni ka pesë qendra rajonale në Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prishtinë dhe Prizren, me ekipe tereni që mbulojnë të gjitha 38 komunat në mbarë Kosovën.

Mandati

Mandati i Misionit, i përcaktuar në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe Vendimin e Këshillit të Përhershëm të OSBE-së nr. 305 të datës 1 korrik 1999, i jep Misionit “rol udhëheqës në çështjet që kanë të bëjnë me ndërtimin e institucioneve, demokracisë dhe të drejtave të njeriut”.

Misioni punon ngushtë me misionet e tjera të OSBE-së në Evropën Juglindore për të përmirësuar bashkëpunimin rajonal, dialogun dhe pajtimin.



Misioni punon me institucionet për t'i mbështetur në ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare në Kosovë. Raporti tematik i Misionit “Mbrojtja e Trashëgimisë Kulturore në Kosovë” publikuar në vitin 2022 shqyrton praktikat aktuale dhe ofron rekomandime për institucionet përkatëse.



Misioni i kushton vëmendje të veçantë fuqizimit të grave. Nisma e Misionit ‘Akademia e Dialogut për Gra të Reja nga Prishtina e Beogradi,’ bashkë-organizuar me Misionin në Serbi, mbledh çdo vit gra nga të dy shoqëritë për të promovuar lidheshipin, dialogun dhe ndërtimin e paqes.

Puna jonë

Aktivitetet e Misionit udhëhiqen nga katër parime: integrimi i shumë-etnicitetit, tolerancës, dialogut dhe pajtimit; promovimi i barazisë, transparencës institucionale dhe llogaridhënies; qëndrueshmëria; dhe avancimi i të drejtave gjinore, të të rinjve dhe komuniteteve.

Misioni avancoi barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave dhe vajzave përmes të gjitha programeve të veta, ndërkohë që mbështet institucionet në zbatimin e kornizave ligjore dhe politikave të ndjeshme gjinore.

Misioni ka tre departamente programatike: Departamentin për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete, Departamentin e Demokratizimit, dhe Departamentin e Sigurisë e Rendit Publik.

Të drejtat e njeriut dhe komunitetet

Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut dhe të drejtave të komuniteteve në Kosovë janë ndër objektivat kryesore të Misionit.

Misioni fokusohet në të drejtat e komuniteteve jo-shumicë duke avokuar për pjesëmarrjen e tyre të plotë në vendimmarrje, siguri, të drejtat gjuhësore dhe arsimimin e tyre. Misioni monitoron procesin e kthimit dhe ri-integrimit dhe avokon për të drejtat pronësore të personave të zhvendosur, grupeve të cënueshme dhe veçanërisht grave. Në këto fusha, monitoron dhe avokon për pajtueshmërinë e institucioneve me instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe zbatimin e duhur të legjislatcionit

në fuqi. Si anëtar i Këshillit për Zbatim dhe Monitorim, i cili ka mandat të ruajë dhe mbrojë trashëgiminë kulturore dhe fetare, Misioni kontribuon në zbatimin e plotë të legjislatcionit për zonat e veçanta të mbrojtura dhe ofron trajnimin e duhur.

Si një nga akterët kyç ndërkombëtar, Misioni shqyrton projektligjet dhe dokumentet e politikave për pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe parimet e sundimit të ligjit. Programi i Misionit për monitorim të gjykatave monitoron gjykimet në të gjitha fazat në mbarë Kosovën për pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare për gjykim të drejtë dhe të drejta të njeriut. Bazuar në këtë monitorim, Misioni publikon raporte që ofrojnë rekomandime praktike për institucionet dhe akterët e sistemit të drejtësisë, përfshirë rekomandime për trajnime dhe ndryshime të sugjeruara legjislative. Misioni gjithashtu forcon kapacitetet e institucioneve jo-gjyqësore dhe organizatave të shoqërisë civile në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Përveç promovimit të dialogut ndër-fetar, Misioni mbështet forcimin e marrëdhënieve ndërmjet komuniteteve dhe institucioneve fetare dhe pjesëmarrjen e tyre në mekanizmat e sigurisë lokale,

si dhe promovon angazhimin e tyre në parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që çojnë në terrorizëm. Përveç kësaj, Misioni mbështet institucionet për të ri-integruar personat e riatdhesuar nga zonat e konfliktit.

Në përputhje me prioritetin për barazi gjinore, Misioni punon me institucione dhe OJQ për të trajtuar dhunën në familje dhe për të mbrojtur të drejtat e viktimave. Misioni përmirëson mbështetjen për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje duke monitoruar zbatimin e kornizës ligjore dhe të politikave, duke forcuar kapacitetet e ofruesve të shërbimeve në mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, dhe duke bërë ndërgjegjësimin e publikut për të drejtat e viktimave.

Demokratizimi

Misioni ofron mbështetje për institucionet qeveritare në kryerjen e funksioneve të tyre në veçanti apo edhe si tërësi e një sistemi të integruar të qeverisjes së mirë. Misioni punon me Kuvendin e Kosovës, institucionet e pavarura dhe komunitatet për ngritjen e kapaciteteve të tyre për të mbajtur nën kontroll pushtetin ekzekutiv dhe mbështet të gjitha nivelet e qeverisjes për të përmirësuar ko-ordinimin ndërqeveritar në hartimin dhe zbatimin e politikave.

Misioni ndihmon institucionet e pavarura në respektimin e standardeve demokratike dhe rritjen e cilësisë së punës së tyre, në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare. Gjithashtu forcon proceset zgjedhore duke mbështetur organet e menaxhimit të zgjedhjeve për të siguruar që zgjedhjet administrohen në mënyrë profesionale dhe të ndershme.

Në nivel lokal, Misioni këshillon komunitatet për çështje si zhvillimi

i buxhetit dhe proceset e auditimit, e-qeverisja, buxheti i përgjegjshëm gjinor, bashkëpunimi ndër-komunal, hartimi ligjor, hartimi dhe zbatimi i politikave, qeverisja mjedisore, zbatimi efektiv i të drejtës për qasje në dokumente publike dhe të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale.

Misioni përqipet të përmirësojë pajtueshmërinë e institucioneve kryesore të medias, duke përfshirë transmetuesin publik, Këshillin e Mediave të Shkruara të Kosovës dhe Komisionin të Pavarur të Mediave, me kornizën ligjore e rregullatore dhe standardet ndërkombëtare, përmes monitorimit, raportimit dhe nismave avokuese.

Misioni punon me median për të forcuar kapacitetet e profesionistëve medial dhe për të rritur ndërgjegjësimin publik si për mbrojtjen e profesionit të medias ashtu edhe për të krijuar mjedis më të sigurt për gazetarët. Fokus tjetër i fuqishëm i punës së Misionit është zgjerimi i edukimit medial dhe informativ.

Misioni ka qasje gjithëpërfshirëse për të forcuar pjesëmarrjen publike të organizatave të shoqërisë civile dhe të rinjve dhe kontributin e tyre në dialogun ndërmjet dhe brenda komuniteteve. Në veçanti, Misioni promovon pjesëmarrjen e barabartë dhe gjithëpërfshirëse të publikut në proceset e politikave dhe vendim-marrjes në të gjitha nivelet, me fokus të veçantë tek gratë e reja, të rinjtë që u përkasin komuniteteve jo-shumicë, të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe ata nga zonat e largëta.

Në përputhje me angazhimet e OSBE-së, Misioni është i prirur të avancojë agjendat për Rininë, dhe për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, përfshirë edhe përmes nismave si Akademia e Dialogut për Gra të Reja nga Prishtina dhe Beogradi, organizuar së bashku me Misionin e OSBE-së në Serbi.

Puna jonë

(vazhdim)

Rendi dhe siguria publike

Misioni i ofron Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe agjencive të saj të sigurisë publike mbështetje të shumë-anshme për të parandaluar dhe luftuar kërcënimet e sigurisë dhe për të nxitur një mjedis të sigurt për të gjitha komunitetet në Kosovë. Fokusohet kryesisht në mbështetjen strategjike dhe ngritjen e kapaciteteve për policinë dhe agjencitë e tjera të sigurisë publike në mënyrë që të rriten aftësitë e tyre në parandalimin dhe luftimin e krimeve të ndryshme të rënda dhe të organizuara. Misioni po ashtu ndihmon Agjencinë e Forenzikës dhe Njësinë e Forenzikës së Policisë së Kosovës, si dhe Inspektoratin Policor e Policinë e Kosovës. Ndihma e shënjestruar për ngritjen e kapaciteteve shtrihet edhe për njësitë e operacioneve speciale të policisë për trajtimin kompetent të kërcënimeve të

shoqëruara me incidente kritike dhe armë të vogla e të lehta.

Misioni mbështet Shërbimin korrektues dhe atë sprovues me trajnime të avancuara dhe të specializuara në nivel operativ, dhe ofron ekspertizë e këshilla të brendshme në nivel strategjik. Gjithashtu ofron ekspertizë dhe ndihmë në formë të këshillave për nivelin ekzekutiv të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike për forcimin e kapaciteteve të saj dhe kontrollin e brendshëm të cilësisë së programeve të trajnimit.

Për të nxitur dialogun ndërmjet komuniteteve dhe Policisë, Misioni punon për të zgjeruar partneritetin polici-qytetar. Ka themeluar një numër forumesh të sigurisë në bashkësi për të adresuar çështjet lokale të rendit dhe sigurisë, dhe vazhdon të zgjerojë dhe forcojë forume të tilla në mbarë Kosovën.



Misioni e ndihmon Agjencinë për Forenzikë dhe Njësinë për Forenzikë të Policisë së Kosovës përmes trajnimit të zyrtarëve të tyre. Ne mars 2023, Misioni ka ofruar trajnime për hetues të vendit të ngjarjes në ekzaminimin e provave të gjurmëve të gishtërinjve.

Misioni punon edhe me policinë në komunitet dhe forumet e sigurisë në komunitet, duke i angazhuar ata në trajtimin e ekstremizmit të dhunshëm, drogave të paligjshme, krimit të urrejtjes, trafikimit të qenieve njerëzore dhe dhunës ndaj grave, përfshirë dhunën në familje, në nivelin bazë. Për më tepër, Misioni punon me Policinë për të avancuar shpërndarjen operative të strategjisë së policimit në komunitet dhe të udhëhequr nga inteligjenca.

Misioni mbështet policinë, agjencitë e sigurisë publike dhe asociacionet


profesionale të grave për të rritur numrin e grave në polici, si në grada ashtu edhe në pozita drejtuese, përmes trajnimeve, avokimit për ndërgjegjësim dhe mentorimit, duke përfshirë ndihmën në zbatimin e agjendës strategjike të barazisë gjinore të policisë.

Misioni gjithashtu angazhohet me të rinjtë për deliktuencën e të rinjve, veçanërisht në tema të tilla si parandalimi i abuzimit me drogën dhe krimet e urrejtjes, dhe rrit kapacitetet e policëve për të hetuar motivet e paragjykitimit.

Fakte dhe shifra



Shef i Misionit
Ambasadori Michael Davenport



Personeli
491 pozita, 115 personel ndërkombëtar dhe 376 vendorë. Personeli i Misionit është i vendosur në selinë e OSBE-së në Prishtinë dhe në pesë qendra rajonale - Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prishtinë dhe Prizren.



Buxheti
17,462,600 Euro

Follow OSCE



Misioni i OSBE-së në Kosovë
Abdyl Frashëri 12, 10000 Prishtinë

+383 38 240 100
OSCEKosovo-COMMS@osce.org
www.osce.org/mission-in-kosovo
@oscekosovo



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Kosovë